



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. të datës 09.10.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 15.09.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 25.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi i drenazhes dhe sanime tjera në shkollën "Xhavit Ahmeti" dhe në IEAA tjera" me nr. të prokurimit 616-23-9530-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. e datës 09.10.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 15.09.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 25.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi i drenazhes dhe sanime tjera në shkollën "Xhavit Ahmeti" dhe në IEAA tjera" me nr. të prokurimit 616-23-9530-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 09.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 15.09.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 25.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi i drenazhes dhe sanime tjera në shkollën "Xhavit Ahmeti" dhe në IEAA tjera" me nr. të prokurimit 616-23-9530-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:** “Ne deshmin e kerkeses nr 2 keni kerkuar qe stafi teknik prej 10 punetoreve ne pikat a, b, c, d te deshmohet me diploma te noterizuar. Kjo deshmi qe te ofrohen diploma te noterizuar per stafin teknik-njeshterit eshte ne kundershitim me nenpiken 6.1 te paragrafit 6 te nenit 69 LPP , gjithashtu ne kundershitim me nenpiken 6.4 te paragrafit 6 te nenit 69 LPP. Kualifikimet shkollore dhe profesional lejohen qe te kerkohet vetem te personelit udhheqes te operatorit ekonomik qe jane persona drejteperdrejte per realizimin e projektit. Ne kete rast lejohet qe te kerkohet kualifikimi shkollore vetem per Inxhinierat, ndersa per stafin teknik sipas nenparagrafit 6.4 te paragrafit 6 te nenit 69 LPP lejohet vetem Lista Mesatare e te punesuareve ne 3 vitet e fundit. Nuk parashkohet qe te kerkohen diploma. Ne piken C nje punetore te trajnuar per vendosjen e gypave, ku ne pozicion 1.9 jane parapare vetem 280m1 gyp drenazhi , ku kete pune per vendosjen e gypave te drenazhes nuk eshte aspak e nevojshme qe me posedu ndonje trajnim pasiqe pune me elementare ne ndertimtari per nje punetore me fizike me te thjeshte pa pervoje pune mund ta kryeje. Ne piken D keni kerkuar nje punetore per testimin e rrjetit. Edhe kete pozicion qe eshte parapare te realizohet nr 1.9 eshte gyp drenazhi, ndersa testimet tjera te gypave nuk jane parapare, ket testim gypit te drenazhes mund ta kryej edhe nje punetore me i thjeshte. Ne kriterin e kerkuar nr3 keni kerkuar gypa per largimin e mbeturinave, ku specifikoni minin 30 copa , mendoje se specifikimi min 30 copa eshte e pa arsyeshme pasiqe kompanite mund te ken faturat, dudat ku nuk specifikohen sasia ne njesi, por ne kg, komplet etj. Ndoshta nuk eshte e nevojshme 30 copa por mjaftojne 5 copa, andaj duhet specifiku min 30 copa”.

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësi kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht me datë 18.08.2023 njësi kërkuese ka dërguar përgjigjen si në vijim:**  
“**PERGJIGJE NE SQARIME**

1. OE duhet te ofroj dy teknike te ndertimarise me pervoje 3 vjecare me diplome ashtu sic eshte specifikuar ne dosje te tenderit. Deshmia – kopjet e diplomave qe deshmon kualifikimin shkollor pa noterizim. CV qe deshmon pervojen e punes si dhe referencat. Kontratat per angazhim per kete projekt.
2. OE duhet te ofroj nje Inxhinier te Menaxhimit te Emergjenteve ku te jete i certifikuar per siguri dhe shendet ne pune. OE mund te ofroje edhe certifikaten e dhenies se provimit profesional per inxhinierin lidhur me sigurine dhe shendetin ne pune qe eshte certifikuar nga nje Institucion Publik me kompetence (Ministria e Punes dhe Mireqenies Sociale).
3. OE duhet te ofroje 10 punetor teknik. Deshmia – Kopjet e Diplomave qe deshmon kualifikimin akademik si dhe listen e punetoreve te angazhuar nga OE per kete projekt apo kontratat.
4. Nje punetor te trajnuar per pllake gipsi do te largohet si kriter.
5. Nje punetor me pervoje per testim te rrjetit – deshmi CV dhe Kontrate per angazhim
6. Min 10 cope gypa per largimin e mbeturinave – deshmia dud doganor apo fature te blerjes.”.

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 20.10.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.